



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada – Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede Sumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**


---

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MBPZHR) – NR. 01/2020**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 10/2010 PËR NDRYSHIMIN DHE**  
**PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.41/2006 PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS**  
**BUJQËSORE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MAFRD) - NO. 01/2020**  
**ON THE AMENDMENT AND SUPPLEMENT OF THE ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO.10/2010 ON**  
**AMENDMENT AND SUPPLEMENT OF THE ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 41/2006 FOR CHANGING THE**  
**DESTINATION OF AGRICULTURAL LAND**

---

**ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (MPŠRR) - BR. 01/2020**  
**O PROMENI I DOPUNI ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA BR. 10/2010 O PROMENI I DOPUNI**  
**ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA BR.41/2006 ZA PROMENU DESTINACIJE POLJOPRIVREDNOG ZEMLJIŠTA**



<b>Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</b>	<b>Minister of the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development,</b>	<b>Ministar poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja,</b>
<p>Në mbështetje të nenit 30 paragrafi 30.1, nenit 31 paragrafi 31.1 dhe 31.2, nenit 44 paragrafi 44.2 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare Nr.13 / 01 qershor 2007), duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/01 gusht 2008), nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, Shtojca 2 të Rregullores (QRK) - NR.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyres së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020), si dhe nenin 38 paragrafi 6 të Rregullores Nr.09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.15/12 shtator 2011),</p>	<p>Pursuant to article 30, paragraph 30.1, article 31 paragraph 31.1 and 31.2, article 44 paragraph 44.2 of the Law No. 02/L-26 on Agricultural Lands (Official Gazette of the Republic of Kosovo No. 13/01 June 2007), taking into account article 5 paragraph 5.2 of the Law No. 2003/3 on Kosovo Forests (Official Gazette of the Republic of Kosovo No. 34/01 August 2008), article 8 paragraph 1 sub paragraph 1.4, of the Appendix 2 Regulation (GRK) - NO. 06/2020 on the fields of the administrative responsibilities of the Prime Minister's Office and the Ministries (08.06.2020) as well as article 38 paragraph 6 of the Regulation No.09/2011 on Rules and Procedures of the Government of the Republic of Kosovo (Official Gazette of the Republic of Kosovo /No. 15/12 September 2011),</p>	<p>Na osnovu člana 30 stav 30.1, člana 31 stav 31.1 i 31.2, člana 44 stav 44.2 Zakona Br.02/L-26 o poljoprivrednom zemljištu (Službeni list Republike Kosovo Br.13/01 juna 2007), na osnovu člana 5 stav 5.2 Zakona Br.2003/3 o šumama Kosova (Službeni list Republike Kosovo Br.34/01 avgusta 2008), članu 8 stav 1 podstav 1.4, Prilog 2 Uredbe (VRK) - BR.06/2020 o Oblastima administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstava (08.06.2020), kao i člana 38 stava 6 Uredbe Br.09/2011 o radu vlade Republike Kosovo (Službeni list Republike Kosovo Br. 15/12 septembar 2011),</p>
<p>Nxjerrë:</p>	<p>Issues:</p>	<p>Donosi:</p>
<p><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) – NR. 01/2020 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 10/2010 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 41/2006 PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE</b></p>	<p><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MAFRD) - NO. 01/2020 ON THE AMENDMENT AND SUPPLEMENT OF THE ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 10/2010 ON AMENDMENT AND SUPPLEMENT OF THE ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 41/2006 FOR CHANGING THE DESTINATION OF AGRICULTURAL LAND</b></p>	<p><b>ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (MPŠRR) - BR. 01 /2020 O PROMENI I DOPUNI ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA BR. 10/2010 O PROMENI I DOPUNI ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA BR.41/2006 ZA PROMENU DESTINACIJE POLJOPRIVREDNOG ZEMLJIŠTA</b></p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 1</b> <b>Cilj</b></p>
<p>Ky udhëzim administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.</p>	<p>The present Administrative Instruction shall aim to amend and supplement the Administrative Instruction No.10/2010 on amendment and supplement of the Administrative Instruction No. 41/2006 for changing the destination of agricultural land.</p>	<p>Ovo Administrativno uputstvo ima za cilj promenu i dopunu Administrativnog uputstva Br.10/2010 o promeni i dopuni Administrativnog uputstva Br.41/2006 za promenu destinacije-odredišta poljoprivrednog zemljišta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b></p> <p>Neni 4, paragrafi 13.7 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet fjalia “<b>deri në 5 vite</b>”.</p> <p>Neni 4, paragrafi 13.8 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet fjalia “<b>deri në 5 ha</b>” dhe zëvendësohet me fjalinë “<b>deri në 20 ha</b>” për aktivitetet nga neni 3 paragrafi 2 i këtij udhëzimi administrativ.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b></p> <p>Article 4, paragraph 13.7 of the basic Administrative Instruction the sentence “<b>until 5 years</b>” shall be deleted.</p> <p>Article 4, paragraph 13.8 of the basic Administrative Instruction the sentence “<b>until 5 ha</b>” shall be deleted and shall be replaced with the sentence “<b>until 20 ha</b>” related to activities from article 3 paragraph 2 of this Administrative Instruction.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2</b></p> <p>Član 4, stav 13.7 Osnovnog administrativnog uputstva briše se rečenica “do 5 godina”.</p> <p>Član 4, stav 13.8 Osnovnog administrativnog uputstva briše se rečenica “do 5ha” i zamenjuje se rečenicom “do 20ha” za aktivnosti iz člana 3 stav 2 ovog Administrativnog uputstva.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b></p> <p>1. Toka bujqësore, pyjet dhe tokat pyjore shtetërore mund t’iu jepen me qira personave fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b></p> <p>1. Agricultural land, forests and public forest lands can be leased to natural and legal persons, local and foreign.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b></p> <p>1. Poljoprivredno zemljište, šume i šumska zemljišta mogu se dati u zakup fizičkim i pravnim licima, domaćim i stranim.</p>
<p>2. Toka bujqësore, pyjet dhe tokat pyjore shtetërore mund të jepen me qira për:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. kultivimin e kulturave bujqësore;</p>	<p>2. Agricultural land, forest and public forest lands can be leased for:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Cultivation of agricultural crops;</p>	<p>2. Poljoprivredno zemljište, šume i šumska zemljišta mogu se dati u zakup za:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. uzgoj poljoprivrednih kultura;</p>

<p>2.2. kultivimin dhe shfrytëzimin e produkteve pyjore jo-drunore;</p> <p>2.3. kullota;</p> <p>2.4. ndërtimin e objekteve të përkohshme;</p> <p>2.5. shfrytëzimin e mineraleve sipërfaqësore, rërës, zhavorrit, argjilës, gurëve, depozitë e mbeturinave, hirit industrial dhe mbeturinat e industrisë së drurit;</p> <p>2.6. kultivimin e pemëve drufrutorë, vreshtave dhe kulturave pyjore;</p> <p>2.7. vendosjen e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;</p> <p>2.8. vendosjen e stabilimenteve tjera transmetuese, matëse dhe telekomunikuese; dhe</p> <p>2.9. shfrytëzimin e sipërfaqeve për rrugë dhe qasje në objekte apo toka tjera.</p>	<p>2.2. Cultivation and utilization of non – wood forest products;</p> <p>2.3. Pastures;</p> <p>2.4. Construction of temporary facilities</p> <p>2.5. Utilization of surface minerals, sand, gravel, clay, stones, waste dump, industrial ash and wood industry waste;</p> <p>2.6. Cultivation of tree fruits, vineyards and forest crops;</p> <p>2.7. Settlement of equipment for renewable energy production;</p> <p>2.8. Settlement of other transmission, measuring and telecommunication facilities; and</p> <p>2.9. Utilization of road surfaces and access to other facilities or lands.</p>	<p>2.2. uzgoj i koriçenje-eksploatacija ne-drvnih šumskih proizvoda;</p> <p>2.3. pašnjaci;</p> <p>2.4. izgradnja privremenih objekata;</p> <p>2.5. korišćenje-eksploatacija površinskih minerala, peska, šljunka, gline, kamenja, odlagališta-deponija otpada, industrijskog pepela i otpada drvene industrije;</p> <p>2.6. uzgoj drvnih plodova-voćnjaka, vinograda i šumskih kultura;</p> <p>2.7. ugradnja-uspostavljanje opreme za proizvodnju obnovljivih izvora energije;</p> <p>2.8. ugradnja-uspostavljanje drugih uređaja za prenos, merenje i telekomunikacije; i</p> <p>2.9. korišćenje površina za puteve i pristup drugim objektima ili zemljištu.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e qiradhënies përcaktohet në kontratën e qiradhënies, e cila mund të zgjat deri në dhjetë (10) vite për aktivitetet nga paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij neni, për aktivitetet nga nën paragrafi 2.5 përcaktohet sipas kohëzgjatjes së licencës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në përputhje me Ligjin Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, kurse për</p>	<p>3. The duration of the lease is determined in the lease contract, which can last up to ten (10) years for the activities from paragraph 2 sub paragraph 2.1, 2.2, 2.3 and 2.4, for the activities from sub paragraph 2.5 is determined according to the duration of the license issued by the Independent Commission for Mines and Minerals in accordance with Law No. 03/L-163 on Mines and Minerals, and for activities from</p>	<p>3. Vremensko trajanje zakupa određuje se u ugovoru o zakupu, koja može trajati do deset (10) godina za aktivnosti iz stava 2 pod stav 2.1, 2.2, 2.3 i 2.4, za aktivnost iz pod stava 2.5 određuje se prema vremenskom trajanju licence izdate od Nezavisne komisije za rudnike i minerale u skladu sa Zakonom Br.03/L-163 o rudnicima i mineralima dok za aktivnosti</p>

<p>aktivitetet nga nën paragrafi 2.6, 2.7, 2.8 dhe 2.9 të këtij neni deri në tridhjetë (30) vite.</p> <p>4. Toka bujqësore, pyjet dhe tokat pyjore shtetërore nga paragrafi 1 i këtij neni jepen me qira sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në nenet 32, 33, 34 dhe 36 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore.</p>	<p>sub-paragraph 2.6, 2.7, 2.8 and 2.9 of this Article up to thirty (30) years.</p> <p>4. Agricultural lands, forests and public forest lands from the paragraph 1 of this article are leased according to the terms and procedures as specified in articles 32, 33, 34 and 36 of the Law No. 02/L-26 on Agricultural Land.</p>	<p>iz stava 2.6, 2.7, 2.8 i 2.9 ovog člana do trideset (30) godina.</p> <p>4. Poljoprivredno zemljište, šume i državna šumska zemljišta iz stava 1. ovog člana daju se u zakup prema uslovima i postupcima utvrđenim u članovima 32, 33, 34 i 36 Zakona Br. 02/L-26 za poljoprivredno zemljište.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Përbërja, mandati, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve</b></p> <p>1. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me vendim formon Komision për shqyrtimin e kërkesave për dhënien me qira të tokave bujqësore në përbërje prej pesë (5) anëtarësh: një (1) anëtar nga Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, një (1) anëtar nga Departamenti Ligjor, dy (2) anëtarë nga Instituti Bujqësor i Kosovës dhe një (1) anëtar nga Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, kurse në rolin monitorues një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Ambient, një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një (1) përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Composition, mandate, duties and responsibilities of the Commissions</b></p> <p>1. Secretary General of the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development with a decision forms a Commission for review of requests for leasing of agricultural lands consisting of five (5) members: one (1) member from the Department of Agricultural Policies and Trade, one (1) member from Legal Department, two (2) members from the Kosovo Agricultural Institute and one (1) member from the Department of Finance and General Services, and in monitoring role one (1) representative from the responsible Ministry for Environment, one (1) representative from Ministry of Local Government Administration and one (1) representative from the Agency against Corruption.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Sastav, mandat, dužnosti i odgovornosti komisija</b></p> <p>1. Generalni sekretar Ministarstva poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja odlukom osniva Komisiju za razmatranje zahteva za zakup poljoprivrednog zemljišta koja se sastoji od pet (5) članova: jednog (1) člana iz Departmana za poljoprivrednu politiku i tržišta, jedan (1) član Pravnog Departmana, dva (2) člana Kosovskog poljoprivrednog instituta i jedan (1) član iz Departmana za finansije i generalne usluge, a u nadzornoj ulozi jedan (1) predstavnik Ministarstva nadležnog za životnu sredinu, jedan (1) predstavnik Ministarstva nadležnog za upravu lokalne samouprave i jedan (1) predstavnik Agencije za borbu protiv korupcije.</p>
<p>2. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me vendim formon Komision për shqyrtimin e kërkesave për dhënien me qira</p>	<p>2. Executive Chief of the Kosovo Forest Agency, as an executive agency under the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development with a decision forms a Commission for review of requests for lease of</p>	<p>2. Glavni izvršni šef Kosovske agencije za šume, kao izvršna agencija u Ministarstvu poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, odlukom formira Komisiju za razmatranje zahteva za zakup državnih šuma i šumskih</p>







<p>të pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore në përbërje prej pesë (5) anëtarësh: dy (2) anëtarë nga Drejtoratet e Agjencisë Pyjore të Kosovës, një (1) anëtar nga drejtoria regjionale përkatëse e Agjencisë Pyjore të Kosovës, dy (2) anëtarë nga Departamenti i Pylltarisë nga MBPZHR, kurse në rolin monitorues një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Ambient, një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një (1) përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit.</p> <p>3. Mandati i anëtarëve të Komisioneve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni zgjat dy (2) vite, me mundësi vazhdimi edhe për dy (2) vite.</p> <p>4. Vendimet e Komisioneve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve me të drejtë vote.</p> <p>5. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisioneve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni përcaktohen me Vendim.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b></p>	<p>forests and public forest lands in the composition of five (5) members: two (2) members from the Directorates of Kosovo Forest Agency, one (1) member from the relevant regional directorate of the Kosovo Forest Agency, two (2) members from the Department of Forestry from the MAFRD, and in monitoring role one (1) representative from the responsible Ministry for Environment, one (1) representative from the responsible Ministry of Local Government Administration and one (1) representative from the Agency against Corruption.</p> <p>3. Mandate of members of the Commissions from paragraph 1 and 2 of this article shall last two (2) years, with the possible extension for two (2) years.</p> <p>4. Decisions of the Commissions from paragraph 1 and 2 of this article are dealing with the simple majority of members with the right of vote.</p> <p>5. Duties and responsibilities of the members of the Commissions from paragraph 1 and 2 of this article are defined by the Decision.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b></p>	<p>zemljišta koja se sastoji od pet (5) članova. : dva (2) člana od Direkcija Kosovske agencije za šume, jedan (1) član iz odgovarajuće regionalne direkcije Kosovske agencije za šume, dva (2) člana iz Departmana za šumarstvo iz MPŠRR, dok u nadzornoj ulozi, jedan (1) predstavnik od Ministarstva nadležnog za životnu sredinu, jednog (1) predstavnika Ministarstva nadležnog za upravu lokalne samouprave i jednog (1) predstavnika Agencije za borbu protiv korupcije.</p> <p>3. Mandat članova komisija iz stava 1. i 2. ovog člana traje dve (2) godine, s mogućnošću produženja za još dve (2) godine.</p> <p>4. Odluke komisija iz stava 1. i 2. ovog člana donose se većinom članova sa pravom glasa.</p> <p>5. Dužnosti i odgovornosti članova Komisije iz stava 1. i 2. ovog člana utvrđuju se Odlukom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Transparenca dhe llogaridhënia</b></p> <p>1. Komisionet nga neni 4 dhe neni 8 i këtij udhëzimi administrativ duhet të hartojnë procesverbalet dhe dokumentet tjera përcjellëse nga takimet që mbajnë, t'i ruajnë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Transparency and accountability</b></p> <p>1. Commissions from article 4 and article 8 of this administrative instruction should prepare minutes of meetings and other supportive documents from the meetings that they hold,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Transparentnost i računodavanje</b></p> <p>1. Komisije iz člana 4. i člana 8. ovog administrativnog uputstva izrade-sastavljaju zapisnike i druga prateća dokumenta od sastanaka koje održavaju, čuvaju ih i</p>

<p>dhe protokollojnë në arkivet e tyre zyrtare konform standardeve dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Mbajtja, përditësimi dhe publikimi i listës së kontratave të qiradhënies së tokës bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore është i obligueshëm dhe bëhet në uebfaqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u evidentuar emri i qiradhënësit dhe qiramarrësit, personit fizik apo juridik, data e fillimit dhe skadimit të kontratës – kohëzgjatja, sipërfaqja dhe vendi.</p>	<p>keep and protocol in their official archives in conformity with the standards and legislation into force.</p> <p>2. Keeping, updating and publication of the list of contracts of lease of agricultural lands, forests and public forest lands is obliged and shall be published on the official website of the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development, identifying name of leaseholder and lessor, natural and legal person, date of beginning and expiration of contract – duration, surface and place.</p>	<p>protokoliraju u svojim zvaničnim arhivima u skladu sa važećim standardima i zakonodavstvom.</p> <p>2. Održavanje, ažuriranje i objavljivanje liste ugovora o zakupu poljoprivrednog zemljišta, šuma i državnih šumskih zemljišta je obavezno i vrši se na službenoj veb stranici Ministarstva poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, identifikovanjem imena zakupodavca i zakupca, fizičko ili pravno lice, datum početka i isteka ugovora -vremensko trajanje, površina i mesto.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6 Obligimet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6 Obligations</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6 Obaveze</b></p>
<p>1. Obligimet ligjore që rrjedhin nga ky udhëzim administrativ duhet të përfshihen përmbajtësisht, plotësisht dhe saktësisht në kontratën e qiradhënies të lidhur mes palëve kontraktuese.</p> <p>2. Qiramarrësit nuk i lejohet nënqiraja për tokën bujqësore, pyjet dhe tokën pyjore shtetërore të cilën e merr në shfrytëzim.</p> <p>3. Obligimet tjera që nuk përcaktohen me këtë udhëzim administrativ, rregullohen me kontratën e qiradhënies.</p>	<p>1. Legal obligations that derive from this administrative instruction should be included in the content, fully and precisely in the lease contract entered into between the contracting parties.</p> <p>2. Leaseholders are not allowed to rent agricultural land, forests and public forest lands which they use.</p> <p>3. Other obligations that are not specified by this administrative instruction, shall be regulated by the lease contract.</p>	<p>1. Pravne obaveze koje proizilaze iz ovog administrativnog uputstva treba da se uključe u suštinski, potpuno i tačno u ugovoru o zakupu sklopljenom između ugovornih strana.</p> <p>2. Zakupcu nije dozvoljeno da daju u zakup poljoprivredno zemljište, šume i državno šumsko zemljište koju uzima na korišćenje.</p> <p>3. Ostale obaveze koje nisu utvrđene ovim administrativnim uputstvom regulišu se ugovorom o zakupu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7 Kriteret</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7 Criteria</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7 Kriterijumi</b></p>

<p>1. Kriteret përcaktuese për marrjen me qira të tokës bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore nga qiramarrësit janë:</p> <p>1.1. Certifikata e pronësisë nga Zyra Kadastrale Komunale përkatëse për sipërfaqen e kërkuar;</p> <p>1.2. Kopja e planit nga Zyra Kadastrale Komunale përkatëse për parcelën e kërkuar;</p> <p>1.3. Skica me koordinata për sipërfaqen e kërkuar;</p> <p>1.4. Dëshmi nga komuna përkatëse se aktiviteti i planifikuar nuk është në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal;</p> <p>1.5. Certifikata e biznesit - për personat juridik;</p> <p>1.6. Plani i rikultivimit të sipërfaqës së kërkuar - kur ka ndërrim destinimi;</p>	<p>1. Specified criteria for lease of agricultural land, forests and public forest lands from the leaseholders are:</p> <p>1.1. Certificate of property from the relevant Municipal Cadastral Office for the surface as required;</p> <p>1.2. Copy of the plan from the relevant Municipal Cadastral Office for the parcel as required;</p> <p>1.3. Sketches with coordinations for the surface as required;</p> <p>1.4. Evidence from the relevant municipality that the planned activity is not in contradiction with the Municipal Development Plan;</p> <p>1.5. Certificate of business – for legal persons;</p> <p>1.6. Plan of re - cultivation of the required surface – when there is a change of destination;</p>	<p>1. Određujući kriterijumi za uzimanje pod zakup poljoprivredno zemljište, šuma i državnih šumskih zemljišta od zakupca su:</p> <p>1.1. Sertifikat vlasništva od nadležne opštinske katastarske kancelarije za traženu površinu;</p> <p>1.2. Kopija plana od nadležne opštinske katastarske kancelarije za traženu parcelu;</p> <p>1.3. Skice sa koordinatama za potrebnu površinu;</p> <p>1.4. Dokaz relevantne opštine da planirana aktivnost nije u suprotnosti sa opštinskim razvojnim planom;</p> <p>1.5. Poslovni sertifikat- za pravna lica;</p> <p>1.6. Plan rekultivacije tražene površine - kada ima promene destinacije-odredišta;</p>
<p>1.7. Garancioni nga institucionet financiare të licencuara për lëshimin e garancioneve nga Banka Qendrore e Kosovës në lartësi prej 30% e shumës së paraparë për realizimin në kohë dhe sipas nevojës së planit të rikultivimit sipas Ligjit Nr.02/L-26</p>	<p>1.7. Guarantee from the financial institutions licensed to issue guarantees by the Central Bank of Kosovo in the height of 30% of the intended amount for timely implementation and according to the need of the re - cultivation plan according to Law</p>	<p>1.7. Garancija od finansijskih institucija koje imaju licencu-dozvolu za izdavanje garancija od Centralne banke Kosova u iznosu od 30% od iznosa predviđenog za pravovremenu primenu i prema potrebi plana rekultivacije u skladu sa Zakonom</p>



<p>për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ MA-Nr.36/2006 për rikultivimin e tokës bujqësore - kur ka ndërrim destinimi;</p> <p>1.8. Licencën apo lejen e Rregullatorit përkatës që lejon zhvillimin e veprimtarisë – për veprimtarinë minerare, energjetike, telekomunikuese; dhe</p> <p>1.9. Për zonat e mbrojtura Pëlqim nga Ministria përgjegjëse e Ambientit.</p> <p>2. Kriteret tjera shtesë përcaktuese për marrjen me qira të tokës bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore nga qiramarrësit për sipërfaqen mbi 3 hektarë janë:</p> <p>2.1. Plani i detajuar i biznesit për periudhën dhe sipërfaqen që e kërkon, i cili duhet të përmbajë së paku aspektin financiar, të mbrojtjes së mjedisit, profesional dhe të punësimit;</p> <p>2.2. Dëshmi mbi përvojën e aktivitetit në fushën për të cilën kërkon qiranë e tokës, së paku në tri (3) vitet e fundit.</p>	<p>No. 02/L-26 on Agricultural Land and Administrative Instruction MA-No. 36/2006 for the re - cultivation of agricultural land – when there is a change of destination;</p> <p>1.8. License or permission of the relevant Regulation which allows the development of the action – for the mine, energetic and telecommunication action,</p> <p>1.9. For protected areas the Consent from the responsible Ministry of the Environment.</p> <p>2. Other additional criteria for lease of agricultural land, forests and public forest lands from the leaseholders for the surface above 3 hectares are:</p> <p>2.1. Detailed plan of the business for the period and surface as required, which should contain at least the financial aspect, of environment protection, professional and employment;</p> <p>2.2. Evidence on the experience of the activity in the field for which it requires the land lease, at least in the last three (3) years.</p>	<p>Br.02/L-26 o poljoprivrednom zemljištu i administrativnom uputstvu MA-Br.36/2006 za rekultivaciju poljoprivrednog zemljišta - kada ima promene destinacije;</p> <p>1.8. Licenca ili dozvola nadležnog regulatora koja omogućava razvoj delatnosti - za rudarstvo, energetiku, telekomunikacione delatnosti; i</p> <p>1.9. Za zaštićena područja Saglasnost od nadležnog Ministarstva životne sredine.</p> <p>2. Ostali dodatni kriterijumi određujući za uzimanje pod zakupa poljoprivrednog zemljišta, šuma i državnih šumskih zemljišta od zakupaca za površinu više od 3 hektara su:</p> <p>2.1. Detaljan poslovni plan za period i traženu površinu, koji mora da sadrži najmanje finansijski aspekt, životne sredine, profesionalne zaštite i zaposlenja;</p> <p>2.2. Dokaz iskustva aktivnosti u oblasti za koju traži zakup zemljišta, bar u poslednje tri (3) godine.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Monitorimi i zbatimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Monitor of implementation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Nadgledanje sprovođenja</b></p>

<p>1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural bën monitorimin e zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ, përmes formimit të një Komisioni të veçantë në përbërje prej tre (3) anëtarësh të emëruar nga Ministri.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni caktohen me Vendim.</p> <p>3. Mandati i anëtarëve të Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni zgjat tri (3) vite, me mundësi vazhdimi edhe për tri (3) vite tjera.</p>	<p>1. Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development shall do the monitor of implementation of this Administrative Instruction, through the formation of a special Commission in the composition of three (3) members appointed by the Ministry.</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Commission from the paragraph 1 of this article shall be defined by the Decision.</p> <p>3. Mandate of the members of Commission from paragraph 1 of this article shall last three (3) years. With the possible extension and for three (3) other years.</p>	<p>1. Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja za nadgledanje sprovođenja ovog Administrativnog uputstva formiranjem posebne komisije u sastavu od tri (3) člana nominovanih od Ministara.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Komisije iz stava 1. ovog člana utvrđuju se Odlukom.</p> <p>3. Mandat članova Komisije iz stava 1. ovog člana traje tri (3) godine, s mogućnošću produženja za još tri (3) godine.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Entry into force</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Stupanje na snagu</b></p>
<p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p>	<p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosova.</p>	<p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od dana objavljivanja u Službenom Listu Republike Kosova.</p>
<p style="text-align: right;"><b>Besian MUSTAFA</b></p> 	<p style="text-align: right;"><b>Besian MUSTAFA</b></p> 	<p style="text-align: right;"><b>Besian MUSTAFA</b></p> 
<p>Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Minister of the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development</p>	<p>Ministar Ministarstva Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja</p>
 <p style="text-align: right;">11 / 06 / 2020</p>	 <p style="text-align: right;">/ 06 / 2020</p>	 <p style="text-align: right;">/ 06 / 2020</p>